


Miratohet



Kryetari i Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet  
Minister i Shendetësisë  
Vangjel Tavo



Vangjel Tavo

Sekretari  
Rustem PACI

POLITIKAT PËR MENAXHIMIN E SIGURTË TË MBETJEVE  
RADIOAKTIVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË.

Nr 1318 / prot 3

datë 25 - 3 - 013

# POLITIKAT PËR MENAXHIMIN E SIGURTË TË MBETJEVE RADIOAKTIVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË.

## Hyrja

Çdo burim radioaktiv ose material i ndotur me lëndë radioaktive që nuk mund të përdoret më tej për qëllime të dobishme përbën mbetje radioaktive. Mbetjet radioaktive si rregull krijojen gjatë punës me burime radioaktive në formë të hapur ose të myllur. Meqënëse mbetjet radioaktive lëshojnë rrezatime jonizuese, të cilat potencialisht mund të dëmtojnë shëndetin e njeriut dhe të ndotin mjedisin, është i nevojshëm një menaxhim i sigurt i tyre nga gjenerimi deri në depozitimin përfundimtar.

Mbetjet radioaktive gjenerohen nga ushtrimi i veprimitarive të mëposhtme:

- Përdorimi i lëndëve radioaktive në fushën e mjekësisë, industrisë, bujqësisë, kërkimit dhe arsimit.
- Nxjerra, përpunimi dhe djegia e lëndëve të para që përbajnë materiale radioaktive natyrore (NORM, TENORM).
- Myllja e qendrave që përdorin lëndë radioaktive ose nga punimet përmirësuese mjedisore pas ngjarjeve të jashtëzakonshme (emergjencave të rrezatimeve).

Mbetjet radioaktive mund të gjenerohen në trajtë të ngurtë, të lëngët ose të gaztë dhe mund të janë me radioaktivitet të ulët (mjekësia bërthamore) deri me radioaktivitet të lartë (burimet e konsumuara të radioterapisë). Ato ndryshojnë edhe përsa i përket përqëndrimit të radioizotopeve, periodës së përgjysmimit, radioizotopeve që ndodhen në to, radiotoksitetit. Mbetjet radioaktive në raste të vecanta mund të gjenerohen së bashku me materiale të tjera të rezikshme kimike ose biologjike. Nivelet e rrezatimeve që lëshojnë mbetjet radioaktive pas trajtimit të tyre, me kalimin e një kohe të nevojshme (muaj, vite ose dekada), si rregull janë të afërtë me nivelet natyrore të rrezatimeve.

Mbetjet radioaktive që gjenerohen nga qendrat e ndryshme variojnë nga vëllime të vogla (burime radioaktive të konsumuara) deri në vëllime të mëdha sikurse mund të janë materialet radioaktive natyrore ose të pasuruara teknologjikisht.

Politika e menaxhimit të sigurt të mbetjeve radioaktive përbën një angazhim në shkallë kombëtare për të realizuar një veprimtaritë të koordinuar dhe bashkëpunuese ndërmjet grupeve të interesit në vend në këtë fushë.

Dokumenti i politikës së menaxhimit të sigurt të mbetjeve radioaktive paraqet rëndësi të veçantë për të gjithë përdoruesit e lëndëve radioaktive në vendin tonë. Politikat e Republikës së Shqipërisë për trajtimin e mbetjeve radioaktive mbështeten në praktikat më të mira botërore si dhe janë në përputhje me detyrimet e Shqipërisë në konventat ndërkombëtare. Politika është e rëndësishme për të përcaktuar rrugët që duhet të ndjekë përpunimi i mbetjeve radiaktive deri në depon përfunditare në Shqipëri për të siguruar publikun dhe ambientin sot dhe në të ardhmen.

Egziston një numër burimesh radioaktive si dhe mbetje në vendin tonë të cilat janë vendosur në depon e përkohshme në priti për të përcaktuar një depo përfundimtare.

Shqipëria ka në fuqi një legjislacion te përshtatshëm në përputhje me konventat dhe detyrimet ndërkombëtare për sigurinë dhe sigurimin e mbetjeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë.

## OBJEKTIVI

Objektivi i këtij dokumenti është për të përcaktuar elementët kryesorë kombëtare për menaxhimin e sigurtë dhe sigurimin e mbetjeve radioaktive .

## PËRCAKTIME

Politika përbën një grup kërkesash bazë të vendosura për menaxhimin e sigurte dhe sigurimin e mbetjeve radioaktive .

## PARIMET PËR KRIJIMIN E POLITIKAVE PËR TRAJTIMIN E MBETJEVE RADIOAKTIVE.

Në përputhje me standartet bazë të sigurisë është e detyrueshme që mbetjet radioaktive të trajtohen në mënyrë të tillë që të mbrohet shëndeti i publikut dhe ambienti për tanit dhe në të ardhmen pa krijuar një precedent për gjeneratat e ardhshme.

Bazuar në principet e mbrojtjes nga rrezatimet të përcaktohet qartë:

- Përgjegjësia për sigurinë dhe sigurimin.

Përgjegjësinë kryesore për sigurinë dhe sigurimin e ka personi fizik ose juridik i cili zhvillon aktivitetin me burime radioaktive ose mbetje radioaktive .

*Qeveria ka përgjegjësinë për mbështetjen e Komisionit te Mbrojtjes nga rrezatimet si një strukture efektive rregullatore për sigurinë dhe sigurimin e materialeve radioaktive.*

Një sistem menaxhimi efektiv duhet të krijohet me qëllim që organizmi për trajtimin e mbetjeve radioaktive të jetë i qëndrueshëm në qendrat ku do te zhvillohet aktiviteti për trajtimin e mbetjeve radioaktive.

Zhvillimi i kësaj politike merr në konsideratë:

- Strukturën kombëtare aktuale për trajtimin e mbetjeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë.Kjo konsiston në menaxhimin e mëtejshëm të mbetjeve radioaktive deri në vendosjen në depon përfundimtare.
- KMR do të rishikojë gjithë strukturën rregullatore për ta sjellë atë në linjë me këtë dokument dhe standartet ndërkombëtare.
- Menaxhimi i mbetjeve radioaktive do të bëhet në zbatim të konventave ndërkombëtare ku bën pjesë Shqipëria në lidhje me mbetjet radioaktive.Gjithashtu Shqipëria merr në konsideratë dhe zbatimin e gjithë legjisacionit Evropian për trajtimin e mbetjeve në këtë fushë.
- ZMR mban inventarin kombëtar të mbetjeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë.
- Mbetjet të cilat prodhohen nga përdorime të ndryshme jashtë juridiksionit të ligjit menaxhohen në mënyrë të plotë duke marrë në konsideratë vetëm ato, të ndara nga veprimtaria e mëparshme.

- Politika e Shqipërise në lidhje me mbetjet do të jetë e tillë, që ndotësit paguajnë, ku cdo person juridik e fizik duhet të sigurojë fondet e nevojshme dhe domosdoshme për trajtimin e mbetjeve.
- Shqipëria do të marrë në konsideratë praktikat më të mira nga vendet e tjera për menaxhimin e sigurtë të mbetjeve radioaktive.
- Të gjithë aktorët kryesorë duke përfshirë edhe publikun do te kenë rol në hartimin e strategjisë për trajtimin e mbetjeve radioaktive.
- Shqipëria mbështet fuqishëm politikën për rikthimin e burimeve në vendin e origjinës. Marrëveshjet duhet të bëhen përpara fillimit të aktivitetit në lidhje me mundësinë e përpunimit të burimeve të konsumuara.
- Shqipëria merr në konsideratë që për përcaktimin e depos përfundimtare duhet të merret ne konsideratë siguria dhe sigurimi i publikut për sot dhe brezat e ardhshëm.
- KMR ka përgjegjësinë për kontrollin mbi burimet radioaktive dhe mbejtjet që dalin nga to. Në lidhje me burimet jetim për të cilat nuk gjendet pronari, shteti merr përsipër trajtimin e sigurtë të tyre pranë QFBZ. QFBZ krjon mekanizma të përshtatshëm për vënien e tyre nën kontroll.
- QFBZ do te jetë qendra e vetme ne Shqipëri për menaxhimin e mbetjeve radioaktive.
- Kjo qendër do të bëjë grumbullimin, përpunimin dhe ruajtjen e mbetjeve radioaktive. Për depon finale Qeveria të ngarkojë QFBZ për përcaktimin e një vendi të përshtatshëm në lidhje me sigurinë dhe sigurimin i cili do ti nënshtrohet të gjithë procedurave ligjore per licencim dhe inpektim.
- Qeveria mbështet QFBZ për të pasur staf të kualifikuar për menaxhimin e mbetjeve.
- QFBZ-së i sigurohet një mekanizëm i përshtatshëm nga ana e qeverisë për të mbuluar kostot në lidhje me menaxhimin e sigurtë të mbetjeve radioaktive.
- Qeveria e Shqipërisë nëpërmjet KMR siguron që qendra per trajtimin e mbetjeve radioaktive ofron siguri dhe sigurim për publikun dhe stafin.
- Gjeneruesit e mbetjeve radioaktive duhet në mënyrë të vazhdueshme të punojnë për minimizimin e mbetjeve radioaktive në cdo stad.
- Shqipëria nuk lejon importin e mbetjeve radioaktive, por lejohet eksporti i burimeve të konsumuara ose transferimi i mbetjeve radioaktive në një qendër tjeter për trajtimin e tyre jashtë vendit. Ekporti i tyre bëhet në zbatim të dispozitave ndërkombëtare. Burimet e kunsumuara mbahen gjatë gjithë kohës nën kontroll duke parë mundësinë e rikthimit të tyre tek vendi i origjinës dhe në qoftë se nuk është e mundur të trajtohen në QFBZ në përputhje me kriteret e pranimit.

Qeveria e Shqipërisë do të rishikojë legjislacionin dhe kornizën rregullatore për një menaxhim më të mirë dhe më të sigurtë të mbetjeve radioaktive. Korniza ligjore do të përfshijë rishikimin e sistemit të licencimit të aktiviteve për përpunimin e mbetjeve radioaktive. Trupa rregullatore KMR do të ngarkohet për zbatimin e legjislacionit dhe rregulloreve dhe do të lëshojë licencat përkatëse në këtë fushë.

Personi fizik ose juridik i licencuar i qendrave të cilat prodhojne mbetje radioaktive do të jetë përgjegjës për menaxhimin e sigurtë të mbetjeve deri në momentin që mbetjet radioaktive janë pranuar nga organizmi përgjegjës për trajtimin e mbetjeve. QFBZ do të jetë përgjegjës për menaxhimin e sigurtë të mbetjeve radioaktive ,përfshirë këtu dhe burimet e konsumuara të cilave nuk u gjendet pronari.

Personi fizik ose juridik i licencuar i qendrave të cilat prodhojnë mbetje radioaktive të adoptojë masa për të zvogëluar prodhimin e mbetjeve radioaktive.

Organizmi përgjegjës, (QFBZ) për trajtimin e mbetjeve do të përgatisë, strategjinë me masat përkatëse për menaxhimin e mbetjeve radioaktive në terma afatgjatë dhe do ia paraqesë nëpërmjet KMR qeverisë për miratim.

Të gjithë aktivitetet për menaxhimin e mbetjeve radioaktive do të bëhen në mënyrë të hapur dhe transparente, ku publiku do të ketë akses në informacionin në lidhje me menaxhimin e mbetjeve përsa kohë kjo nuk dëmton sigurinë kombëtare ose nuk është në kundërshim me ligjin .